

KËRKESË
Nr. 314, datë 6.2.2020

**PËR BOTIMIN E VENDIMIT PËR DËNIM ADMINISTRATIV NDAJ SUBJEKTIT “KORSEL”
SHPK**

ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, meqenëse ka realizuar njoftimin zyrtar për vendimin përfundimtar të inspektimit, nëpërmjet shërbimit postar është kthyer njoftimi i institucionit tonë (në adresën ku kryen aktivitet dhe në adresën e pasqyruar në QKB), duke u konfirmuar nga shërbimi postar: ka ndryshuar adresë.

Sa më sipër, ISHSH-ja, Dega Rajonale Qarku Vlorë, duke qenë se Posta Shqiptare e ka të pamundur komunikimin e masës administrative, bën njoftimin publik të vendimit përfundimtar të inspektimit nr. ISHSH VL-2019 000207-5, datë 21.3.2019, për subjektin Maksim Fejzulla, “Korsel” sh.p.k., me adresë: fshati Gjashtë, pranë karburantit “Islamaj”, Sarandë.

KRYEINSPEKTOR
Lorenc Rexho

VENDIMI PËRFUNDIMTAR I INSPEKTIMIT

Nr. ISHSH-VL-2019-000207-5

Datë 21.3.2019

Bazuar në nenin 46, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, VKM-së nr. 241, datë 27.3.2013, “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor”, dhe procesverbalin e inspektimit nr. ISHSH-VL-2019-000207-2, datë 21.3.2019, inspektim, që është zhvilluar në subjektin “Korsel” sh.p.k., me NIPT: J64104124G, punëdhënës Isuf Lika, përfaqësues i degës Sarandë, prej datës 21.3.2019, ora 8:30:00 deri në datën 21.3.2019, ora 9:30:00.

Grupi i punës, pasi realizoi inspektimin, e hartoi procesverbalin e inspektimit në datën 21.3.2019 dhe e njoftoi në datën 21.3.2019.

Në bazë të procesverbalit të inspektimit dhe të kontestimeve të subjektit të inspektimit rezultuan këto shkelje të kërkesave ligjore:

Ligji nr. 7643, datë 2.12.1992, “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, nenet 26, 27, pika 15/c.

Për shkak të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore të subjektit të inspektimit, në mbështetje të ligjit, mosrealizimi i detyrave të lëna nga trupa inspektuese në inspektimin e datës 6.3.2019, ato klasifikohen si kundërvajtje administrative dhe parashikohen dënimet administrative si më poshtë:

1. Dënim administrativ kryesor:

Gjobë 200 000 lekë

2. Dënim administrativ plotësues:

Korrigjimi i shkeljeve të konstatuara dhe eliminimi i pasojave të tyre në një afat kohor të arsyeshëm. Detyra për t’u realizuar me afate kohore respektive:

Shuma e shpenzimeve për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin apo analizën e mostrave. --

Inspektorët shtetërorë të autorizuar:

Arqile Kaishi	ID_	
Elona Mano	ID_	
Pavjola Zeneli	ID_0412080008	
Personi i autorizuar i subjektit		
Isuf Lika	Përfaqësues i degës Sarandë	Refuzoi firmën

Kundër vendimit përfundimtar të inspektimit, subjekti "Korsel" sh.p.k. ka të drejtën e ankimit brenda 30 ditëve nga data e njoftimit të vendimit përfundimtar. Ankimi paraqitet pranë "organit epror" të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor. Vendimi përfundimtar mbahet në 4 kopje.